



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**

**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL**



**RAPORT TREMUJOR
(tetor – dhjetor 2024)**

**PËR AKTIVITETET DHE REKOMANDIMET E
KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR LUFTIMIN E KRIMIT
EKONOMIK**

Prishtinë, shkurt, 2025

1. HYRJE – Mandati i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimin Ekonomik

Pozita e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimin Ekonomik është krijuar në bazë të një udhëzimi administrativ të lëshuar nga kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) me 27 dhjetor 2013. Personi i emëruar për atë pozitë ka kompetenca dhe përgjegjësi për detyrat në vijim:

1. Koordinimin e aktiviteteve për rritje të vetëdijesimit të të gjitha agjencioneve të përfaqësuara nga nënshkruesit e këtij memorandumi, përmes mediave publike dhe mënyrave tjera, për rreziqet që shoqërohen me dështim dhe benefitet e suksesit të luftimit të krimeve që gjenerojnë dobi pasurore;
2. Mbikëqyrjen e krijimit dhe implementimit të planeve të veprimit, të dizajnuara për të arritur dhe për të mirëmbajtur përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë;
3. Koordinimin e reagimit kombëtar ndaj kërkesave të organizatave ndërkombëtare për zhvillim të ekzaminimeve ose vlerësimeve kundër pastrimit të parasë;
4. Mbikëqyrjen e planifikimit dhe implementimit të programeve të trajnimit të përfshira në mandatin e Institutit kundër Krimin Ekonomik (IKE);
5. Identifikimin e mundësive për përmirësim, praktika më të mira dhe procedura operuese që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e programit dhe komunikimin e kësaj informate tek autoritetet e përshtatshme;
6. Grumbullimin dhe analizimin e informatave në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e entiteteve të involvuara në luftimin e krimeve që gjenerojnë dobi pasurore dhe raportimin e këtyre informatave tek autoritetet e përshtatshme;
7. Sigurimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për arritjen e objektivave të strategjive kombëtare për luftimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe ekonomisë joformale;
8. Rekomandimin e modifikimeve në strategji kombëtare ose legjislacion që do të përmirësonte përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë ose rritjen e efikasitetit apo efektivitetit të programit,
9. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë punën e të gjitha institucioneve relevante në R. e Kosovës lidhur me procesimin e rasteve që hyjnë në kuadër të kësaj rregulloreje dhe memorandumit të bashkëpunimit;
10. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë dhe do të përcjellë procedimin e rasteve nga institucioni në institucion;
11. Koordinatori mund të propozojë udhëzime për institucionet në fjalë se si të përmirësojnë nivelin e performancës dhe raportimit.

12. Koordinator Kombëtar ka rol të rëndësishëm në dokumentin e aprovuar nga KPK mbi “Procedurat Standarde të Veprimit për përzgjedhjen e shënjestrave të krimeve të rënda dhe bashkëpunimi ndërinstytucional”;
13. Koordinator Kombëtar po ashtu ka rol edhe në dokumentin tjetër strategjik të aprovuar nga Qeveria e R. së Kosovës “Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023”.

Prokurori Shqipdon Fazliu, është caktuar nga KPK-ja për këtë pozitë. Ky raport do të bëjë të ditura aktivitetet e tij dhe të entiteteve të involvuara në tri shtyllat e programit të tij: parandalimi dhe detektimi, trajnimi dhe luftimi i krimit ekonomik.

2. ANALIZA&SUKSESET

Periudha e katërt e vitit 2024, tetor - dhjetor, e gjen sistemin e drejtësisë me rezultate pozitive. Ky konstatim del nga fakti se janë raportuar 207,560.96 € pasuri të konfiskuara përfundimisht, edhe atë në 7 raste, ndërsa që vlera e sekuestrimeve është 3,751,993.56 €, apo me 51 raste të ndryshme me sekuestrim.

Një veçori tjetër pozitive e hasur këtë tremujor, është fakti se ka vazhduar përgjigja për më shumë kërkesa për shitje të aseteve. Në total këtë tremujor janë paraqitur 28 (138 kërkesa ish-in raportuar në TM3) kërkesa për shitje të aseteve. Për dallim nga hera e kaluar kur nuk kemi parë asnjë kërkesë nga PSRK, këtë tremujor janë 4 kërkesa të tilla për shitje nga ana e PSRK-së. KKLKE gjatë ditëve dhe javëve të kaluara ka kërkuar nga ana e koordinatorëve lokal që të intensifikohet puna në paraqitjen e kërkesave të tilla, mirëpo shihet se ka prokurori e prokurorë individual që nuk kanë kthyer përgjigje për këtë çështje fare. Andaj, ne bashkëngjitur me këtë email po dërgojmë tek KPK dhe U.D i Kryeprokurorit të Shtetit, listat me raste të tilla, ndërsa mbetet tash e tutje në KPK-në dhe U.D të Kryeprokurorit të Shtetit, të veprojnë më tutje dhe që të vlerësojnë një situatë të tillë, apo pse nuk ka përgjigje në kërkesat e ligjshme për shitje dhe dëmtimin e vazhdueshëm që po i bëhet buxhetit të shtetit me këtë mos veprim të vazhdueshëm.

Më pas është edhe një fakt tjetër pozitiv që tregohet përmes faktit se 40 prokurorë janë përfshirë në 51 raste të ndryshme me sekuestrim dhe 7 raste me konfiskim.

- Trendi i zgjidhjes së rasteve të krimeve ekonomike në raport me ato të pranuar gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, është pjesërisht negativ. Të dhënat statistikore dëshmojnë se këtë tremujor janë pranuar gjithsej 78 raste të reja me 133 persona, ndërsa që janë zgjidhur 78 raste me 92 persona. Edhe më saktë, duke përdorur përqindjen, del se prokuroritë kanë zgjidhur 100% të rasteve të pranuar dhe 69.17% të rasteve me persona gjatë TM4 të vitit 2024.

-Më tutje, përderisa jemi ende te kjo çështje, është interesante të shihet se nga totali prej 78 rasteve të zgjidhura me persona në TM4, prokuroritë themelore dhe PSRK, së bashku, kanë vendosur të ngrisin aktakuza kundër 60 personave, apo në 59%, ndërsa kanë vendosur të pushojnë hetimet kundër 14 personave apo në 24% të tyre, si dhe kanë hedhur kallëzimet penale kundër 18 personave, apo në 17% të tyre.

- Te vepra penale e shpëlarjes së parave në TM4 të vitit 2024, kemi pasur 5 kallëzime penale të reja të pranuar kundër 22 personave, ndërsa që janë zgjidhur 2 raste me 20 persona.

-Ndërsa, si zakonisht, kur jemi te vendimet e gjykatave paraqitet një situatë pozitive, ngase kemi 21 vendime nga ana e gjykatës. Nga numri prej 21 personave, gjykatat kanë marrë aktgjykime fajësuese kundër 19 personave, në 1 rast është hedhur aktakuza para shqyrtimit gjyqësor, në 0 raste të akuzuarit janë liruar nga aktakuzat dhe në 1 rast është refuzuar aktakuza. Pra, nga totali prej 21 vendimeve për persona, në 90.47% të tyre, gjykatat kanë shpallur personat fajtor sipas aktakuzave, në 4.76% të rasteve janë hedhur aktakuzat para shqyrtimit gjyqësor, në 0% të rasteve të akuzuarit janë liruar nga akuzat dhe në 4.76% është refuzuar aktakuza.

-Tek rastet e evidentuara si INFORMATA apo PPN-të, në TM4 të vitit 2024, janë pranuar 49 raste kundër 55 personave, ndërsa janë zgjidhur 39 raste kundër 40 personave.

3. RASTET E KONFISKIMIT

1. Kështu, rasti i parë vjen nga Pth Prizreni, evidentohet nën shifrat PP.II.nr.2459-5/22, i datës 04.10.2024, për shkak të veprës penale, organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 i KPRK-së (prokurori i rastit Musli Gashi). Në këtë rast kemi 4 të pandehur, G. A. etj., ku fillimisht të pandehurit janë shpallur fajtor dhe u janë shqiptuar dënime.

Me dt. 04.10.2024, PTH në Prizren ka parashtruar kërkesën plotësuese PP.II.nr.2459-5/22, e dt. 04.10.2024, për konfiskimin e përhershëm të PASURISË SHITESË, e cila i nënshtrohet automatikisht konfiskimit.

Në gjykatë, rasti evidentohet nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.283/2023, i datës 12.11.2024 dhe numri SMIL 2022:280229. Gjykata me këtë rast ka marrë aktvendim dhe ka konfiskuar pasuritë shtesë, disa kartëmonedha në vlerë prej 500 €.

2. Rasti i dytë vjen nga Pth Prizreni, evidentohet nën shifrat PPN.II.nr.196-16/24, i datës 13.02.2024, për shkak të veprës penale, falsifikimi i dokumenteve, nga neni 390 paragrafi 1 i KPRK-së (prokurori i rastit Ramadan Koro). Në këtë rast kemi një të pandehur M. B., ku prokurori i rastit kishte kërkuar që vetura Golf-1hxo, të konfiskohet sipas nenit 276 të KPP-së, apo pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit.

Në gjykatë rasti evidentohet nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, Pndr.nr.154/2023, i datës 21.02.2024 dhe numri SMIL 2023:201811. Gjykata me këtë rast ka lëshuar Urdhëresë për konfiskimin e pasurisë në fjalë.

3. Rasti i tretë vjen nga Pth e Pejës, evidentohet nën shifrat PP.II.nr.1853/24, i datës 30.10.2024, për shkak të veprës penale, mashtrimi, nga neni 323 paragrafi 1 i KPRK-së (prokurori i rastit Ermal Demhasaj). Në këtë rast kemi një të pandehur A. G., ku prokurori i rastit kishte lidhur me të pandehurën e përfaqësuar nga avokati mbrojtës, marrëveshjen e fajësisë, edhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, e që me pëlqimin e të pandehurës, dënimi me burg është zëvendësuar me dënim me gjobë në lartësinë e shumës prej 2,000.00 €, ndërsa përpos shqiptimit të dënimit plotësues në

shumën prej 4,480.00 € në emër të dëmit të shkaktuar, të pandehurës në bazë të nenit 269.1 të KPP-së, i është konfiskuar:

- Vetura e tipit Audi Q7 3.0 TDI, viti i prodhimit 2007, si send që është përdorur nga e pandehura për të udhëtuar në takimet e zhvilluara me të dëmtuarin.

4. Rasti i katërt vjen nga PSRK, Departamenti për Hetimin e Krimin të Organizuar, evidentohet nën shifrat PPS.nr.68/22, i datës 09.08.2024, për shkak të veprës penale, organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së (prokurorja e rastit Habibe Salihu). Në këtë rast kemi 10 pandehur A. N. dhe të tjerë, ku prokurorja e rastit kishte ngritur aktakuzën dhe kishte propozuar konfiskimin e 2 aparateve të lojërave të fatit, 2 DVR, 685 euro para të gatshme, 1 Iphone XR, 378 euro, 1 Iphone 13 Pro max, 1265 euro, 1 Iphone 12, 300 euro.

PSRK në këtë rast kishte lidhur edhe 9 marrëveshje të fajësisë me 9 të pandehur.

Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.63/2024, i datës 31.10.2024 dhe numri SMIL 2023:083962. Gjykata me këtë rast ka marrë aktgjykim dënues dhe të dënuarve u ka shqiptuar dënime me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve e që në pajtim me nenin 44.1 të KPRK-së, dënimi me burgim u është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 5,000.00 € etj.

Ndërsa ka vendosur të konfiskoj pasuritë e cekura si më lart.

Ajo që është me rëndësi të theksohet në këtë rast është shuma e ulët e konfiskimit, ndërsa në anën tjetër është fakti se me këtë rast është marrë PSRK dhe sikur e kemi bërë në ditur në disa raste, ne konsiderojmë se ky nuk do të duhej të jetë profili i rasteve me të cilat duhet të merret PSRK sepse paraqet barrë të tepërt për këtë prokurori.

5. Rasti i pestë vjen nga PSRK, evidentohet nën shifrat PPS.nr.114/21, i datës 16.08.2023, për shkak të veprës penale, fajdeja, nga neni 331 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së si dhe lidhur me veprën penale të shpëlarjes së parave nga neni 302 lidhur me nenin 31 i KPRK-së (prokurori i rastit Burim Çerkini). Në këtë

rast kemi 4 të pandehur B. M. dhe të tjerë, ku prokurori i rastit kishte ngritur aktakuzën dhe kishte propozuar konfiskimin e:

- Banesa në sipërfaqe prej 115 m², në katin e tretë i kthehet palëve të dëmtuara;
- Anullohet kontrata e shitblerjes për një ngastër kadastrale dhe e njëjta i kthehet të dëmtuarit.

PSRK në këtë rast kishte lidhur edhe 9 marrëveshje të fajësisë me të pandehurit.

Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.39/2023, i datës 05.11.2024. Gjykata me këtë rast ka marrë aktgjykim dënues dhe të dënuarve u ka shqiptuar dënime me burgim në kohëzgjatje prej 9 muajve me burgim efektiv dhe dënim me gjobë në shumë prej 15,000.00 € etj.

Ndërsa ka vendosur të konfiskoj pasuritë e cekura si më lart.

6. Rasti i gjashtë vjen nga Pth Prizreni, evidentohet nën shifrat PP.II.nr.72-16/24, i datës 08.02.2024, për shkak të veprës penale, falsifikimi i dokumenteve, nga neni 390 paragrafi 1 i KPRK-së (prokurori i rastit Ramadan Koro). Në këtë rast kemi një të pandehur R. J., ku prokurori i rastit kishte kërkuar që vetura Golf-1hxo, të konfiskohet sipas nenit 276 të KPP-së, apo pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit.

Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, Pndr.nr.149/2023, i datës 04.03.2024 dhe numri SMIL 2023:196948. Gjykata me këtë rast ka lëshuar Urdhëresë për konfiskimin e pasurisë në fjalë.

7. Rasti i shtatë vjen nga Pth Prizreni, evidentohet nën shifrat PP.I.nr.47/24, i datës 30.09.2024, për shkak të veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 367 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 i KPRK-së (prokurorja e rastit Ervehe Gashi). Në këtë rast kemi një të pandehur K. Th. Etj., ku prokurori i rastit kishte kërkuar që shuma prej 365 euro në bazë të nenit 277.8 të KPP-së të konfiskohen.

4. KONSTATIMET

- Sistemi i drejtësisë së vendit në vitin 2024 ka shënuar në përgjithësi, rezultat pozitiv. Edhe këtë vit kemi rezultate të mira, si në fushën e sekuestrimit, ashtu edhe në atë të konfiskimit. Janë raportuar më shumë se 2 milionë euro pasuri të konfiskuara përfundimisht, ndërsa në anën tjetër kemi një shifër impresive prej mbi 48 milionë euro pasuri të sekuestruara në raste të shumta dhe të ndryshme.
- Në total në vitin 2024 kemi pasur gjithsej 12 raste që kanë përfunduar me konfiskim. Padyshim se një gjë e tillë paraqet një progres, mirëpo ky progres është vetëm nëse merret parasysh krahasimi me vitet e mëhershme, e veçmas para vitit 2023. Në anën tjetër, nëse shikohet realisht, 12 raste për një sistem të tërë të drejtësisë janë shumë pak.
- Mirëpo, sekuestrimi është në shifra mëse të kënaqshme, ngase janë raportuar jo më pak se 259 raste në total. Por, nga 259 raste të raportuara me sekuestrim, kemi vetëm 12 raste që kanë përfunduar me konfiskim final.
- Nga 12 rastet e përfunduara me konfiskim, Pth Prizreni ka 5 raste, PSRK ka 2 raste, Pth Gjakova ka 2 raste, Pth Mitrovica ka 1 rast, Pth Peja ka 1 rast dhe Pth Prishtina ka 1 rast.
- Pth Gjilani dhe Pth Ferizaj kanë 0 raste të raportuara.
- Kjo është një tregues i qartë se Kryeprokurori i Shtetit në anën operative (shih Ligjin për Prokurorin e Shtetit, neni 21.1.2) dhe KPK përmes vlerësimit të performancës do të duhej të bëjnë analizë të plotë të kësaj situate. Si ka mundësi që shumica e veprave penale në Kodin Penal kanë si motiv dobinë pasurore dhe duke qenë se kjo është e pakontestueshme, atëherë si ka mundësi që të ketë kaq pak raste me konfiskim, si ka mundësi që të ketë zbatim kaq të varfër të nenit 92 të KPRK-së, të këtë zbatim kaq të varfër të dispozitave të konfiskimit në përgjithësi, si ka mundësi që të ketë zbatim kaq të varfër të LKZK-së dhe në fund, si ka mundësi që disa prokurori kanë vetëm nga një rast të raportuar me konfiskim, disa kanë zero raste, ndërsa dy prokuroritë kryesore, si PSRK dhe Pth Prishtina, të kenë së bashku vetëm 3 raste me konfiskim final?

- Në vitin 2023, kemi lansuar edhe Udhëzuesin e Thjeshtësuar për Konfiskimin në Kosovë, që ka të bëjë me zbatimin e dispozitave të konfiskimit në KPRK, KPP, LKZK si dhe rreth hetimeve financiare. Ky Udhëzues do të jetë një ndihmë e madhe për policinë dhe prokurorinë në zbatimin sa më të mirë, efikas dhe unik të dispozitave të tilla. Sidoqoftë, të dhënat nga terreni flasin se Udhëzuesi i lëshuar nga Kryeprokurori i Shtetit, po zbatohet fare pak, ndërsa një analizë më të detajuar do ta japim në fazën e analizimit të zbatimit të nenit 92 të KPRK-së dhe në përgjithësi të dispozitave të konfiskimit.
- Rrjeti i koordinatorëve ka funksionuar në baza të rregullta dhe ka dhënë disa rezultate në këtë drejtim. Një sfidë që duhet të adresohet ka të bëjë me delegimin e koordinatorëve duke pasur parasysh ndryshimet e shpeshta në këtë mekanizëm. Ftojme Kryeprokurorin e Shtetit dhe KPK-në, që përpos situatave kur sistemi përfiton dukshëm nga ndryshimi i statusit të prokurorit, ndryshimet të tilla të bëhen me kujdes dhe vetëm pas një procesi të koordinimit;
- Janë mbajtur trajnime dhe tryeza të rumbullakëta duke diskutuar çështje me rëndësi të dispozitave të sekuestrimit/konfiskimit;
- Një progres që njëkohësisht është edhe sfidë, është zbatimi i LKZK-së. Në janar të vitit 2025 janë bërë plot 6 vite që nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe deri më tani kemi 9 raste të iniciuara. Përderisa, ka pasur progres në vitin e fundit, meqenëse PSRK ka 2 raste të iniciuara dhe Pth Prishtina ka 1 rast tjetër të iniciuar, megjithatë fakti se kemi më shumë se një gjysmë dekade që ka hyrë në fuqi dhe nuk kemi asnjë rast me aktgjykim të plotfuqishëm, tregon se nuk është bërë sa duhet. Praktikant e deritashme nuk do të duhej të vazhdojnë, veçmas në vlerësimin e performancës sepse ligji më i fuqishëm në sistem, mbetet i zbatuar në shifra jo përfillëse.
- Shitja e aseteve të sekuestruara. Edhe kjo pikë në vitin 2024 ka shënuar një progres. Në TM 3 ishin paraqitur rekord kërkesash prej 138 sosh ndërsa në TM4 kishim 28 kërkesa për shitje. Mirëpo, në anën tjetër duhet pranuar se ky problem realisht as nuk do të duhej të ishte krijuar fare sepse paraqet një çështje kaq të thjeshtë të (mos) zbatimit të ligjit. Pra, përkundër një progresi, vazhdon të mbetet pikë çalimi dhe shumë asete vazhdojnë

të zhvlerësohen pamëshirshëm, si mungesë e zbatimit të mundësisë për shitje në fazë sa më të hershme;

- Zbatimi jo konsistent dhe i pamjaftueshëm i mundësive ligjore të konfiskimit tek një numër i madh i veprave penale. Neni 92 në KPRK vazhdon të zbatohet jo sa duhet, përkundër mundësive tejet të gjera që i ofron. Jo vetëm tek veprat penale të krimeve ekonomike, korrupsionit, narkotikëve etj. por ky nen mund të zbatohet në mënyrë shumë më të gjerë edhe te veprat penale kundër pasurisë, mjedisit, shëndetit etj.

5. RAPORTE TË NDRYSHME NGA PROKURORITË RRETH ZBATIMIT TË NENIT 92 të KPRK, DISPOZITAVE TË KONFISKIMIT DHE LKZK-së

Duke pasur parasysh:

1. KPRK-në që ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2019,
2. KPP-në që ka hyrë në fuqi në vitin 2023;
3. LKZK-në që ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2019;
4. Udhëzuesin e Thjeshtësuar të Konfiskimit në Kosovë, të lëshuar nga Kryeprokurori i Shtetit, më 2023;
5. Direktiva 2014/42/BE, e Parlamentit Evropian;
6. Raportet e Progresit të BE-së në vazhdimësi;
7. Trajnimet e seminarit e shumta ndër vite;
8. E shumë dokumente tjera.

Konfiskimi si koncept ka ndryshuar mjaft me ligjet e reja dhe duke pasur parasysh mes tjerash, dokumentet e lartcekura, kemi kërkuar nga koordinorët e secilës prokurori, raporte, me kërkesën për përgjigje, sa është zbatuar neni 92 i KPRK-së, shitja e asetëve etj.

Gjetjet nga raportet e pranuar nga secila prokurori janë shqetësuese në disa aspekte.

Duket se një problem i konsiderueshëm në Kosovë paraqet të kuptuarit e saktë të rolit të secilit zbatues të ligjit në Kosovë dhe mos kalimit të kompetencave. Analizat e fundit që kemi bërë dëshmojnë se zbatimi i nenit 92 të KPRK-së, LKZK-së dhe në përgjithësi të dispozitave të konfiskimit, çalojnë shumë. Kjo, është kryesisht për shkak të tejkalimit të kompetencave të ligj zbatuesve dhe me këtë, më saktë, mendojmë në prokurorët dhe gjykatësit. Kështu, një numër i

prokurorëve dhe gjykatësve “mendojnë” se dispozitat e konfiskimit janë të ashpra dhe joproportionale.

Pyetja jona ka qenë e formuluar si në vijim: të merren mostrat në së paku 5 vepra penale të: tregtisë së ndaluar – neni 299, kontrabandimit me mallra nga neni 311, mashtrimit nga neni 323, vjedhja e rëndë nga neni 315, uzurpimi nga neni 320, vjedhja e pyllit nga neni 349, keqpërdorimi i pozitës zyrtare nga neni 414, ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338, veprat penale të armëve nga neni 264, shpëlarja e parave nga neni 302, vepra penale e narkotikëve nga neni 267. Në të gjitha këto raste, kemi kërkuar të dhëna të kufizuara, kryesisht ato që lidhen me konfiskimin: Pra, a është përdorur neni 92 i KPRK-së në adresimin e dobisë pasurore?

Përgjigjet e prokurorive i kemi përmbledhur si më poshtë:

1. Pth Prishtina ka raportuar se neni 92 ka gjetur zbatim në 3 raste.

Pth Prishtina ka raportuar edhe disa konstatime interesante si në vijim:

“Sa i përket konfiskimit dhe shitjes së pasurisë së lidhur me veprat penale të përmendura më lart, në përgjithësi, nuk kemi hasur vështirësi nga ana e gjykatave, pasi kërkesat e prokurorisë janë aprovuar pothuajse në tërësi.

- Janë aprovuar gjithsejtë 5 kërkesa për konfiskim dhe shitje

- Janë aprovuar gjithsejtë 4 kërkesa për shkatërrim të aseteve të konfiskuara

- Janë aprovuar gjithsejtë 4 kërkesa për kthimin aseteve të sekuestruar.

Megjithatë, janë evidentuar disa raste specifike, ku gjykatat nuk kanë dhënë përgjigje fare lidhur me kërkesat për konfiskim dhe shitje të pasurisë. Deri më tani, janë identifikuar tre raste të tilla, për të cilat është paraqitur një parashtrësë në gjykatë dhe është njoftuar gjithashtu kryetari i gjykatës për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme. Si rezultat i këtyre parashtrësëve, **2 (dy) nga kërkesat për konfiskim dhe shitje të aseteve janë aprovuar, ndërsa një është në pritje”.**

Ajo që është pozitive nga raporti i Pth Prishtinës është komunikimi që kanë pasur me kryetaren e gjykatës dhe pas kësaj duket se vendimet janë lëshuar nga ana e gjykatës. Një qasje proaktive pozitive nga ana e kryeprokurorit në Prishtinë.

2. Pth Ferizaj ka raportuar se kanë 0 raste në zbatimin e nenit 92.

Tek kjo prokurori nga raporti shihet se ka shumë asete që pas fazës së sekuestrimit, më pas me vendim të gjykatës, asetet janë kthyer tek të pandehurit.

Është shqetësues fakti se kjo prokurori ka zero raste me zbatim të nenit 92 si dhe fakti se shumë asete janë kthyer tek të pandehurit që dëshmon se asetet mund të jenë sekuestruar gabimisht pa bazë ligjore.

3. Pth e Gjakovës ka dërguar një përgjigje shumë të detajuar por njëkohësisht edhe shumë interesante. Fillimisht, nga raporti i pranuar nga Pth Gjakova shihet se neni 92 i KPRK-së është zbatuar në 1 rast.

Ndërsa, Pth Gjakova ka dërguar edhe disa konstatime shumë interesante si në vijim:

“Sa i përket pyetjes 1 lidhur me zbatimin e nenit 92 (konfiskimi i instrumentalitetit) ju sqaroj se tek rastet e trajtuara në PTH në Gjakovë, kjo dispozitë në Gjykatë ka gjetur pjesërisht zbatim, pasi që tek veprat penale që ndërlidhen me përfitimin kundërligjshëm të dobisë pasurore me rastin e shpalljes fajtor të të akuzuarit, gjykata ka urdhëruar konfiskimin e pasurisë që është sekuestruar tek i akuzuari si pasuri e përfituar kundërligjshëm, në raste të tjera ka urdhëruar kompensimin e dëmit, **mirëpo në asnjë rast gjykata nuk ka konfiskuar pasurinë e të pandehurit me vlerë të barasvlershme me qëllim të kompensimit të dëmtuarit në rastet kur kompensimi ka qenë i pamundur.**

Sa i përket pyetjes 2 lidhur me zbatimin e udhëzuesit tek kërkesat për shitje, ju sqaroj se në të gjitha rastet ku ka ekzistuar baza ligjore për një kërkesë të tillë, kemi parashtruar kërkesë për shitjen e aseteve, ndërsa gjykatat pothuajse në të gjitha rastet e kanë aprovuar kërkesën e prokurorisë, me përjashtim të rasteve kur kemi të bëjmë me veprat penale “Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 i KPRK-së” ku gjykatat në këto raste kanë refuzuar konfiskimin e përhershëm dhe shitjen e tyre me arsyetimin se vlera e sendeve është dukshëm më e lartë se dëmi apo pasoja e shkaktuar.

Po ashtu edhe tek vepra penale Vjedhja e pyllit **jo çdoherë** konfiskohen dhe shiten mjetet me të cilat është kryer penale, (psh.Traktor apo kombi bus) me arsyetimin se këto mjete nuk janë të destinuara për kryerjen e veprës penale por janë mjete që përdoren për nevoja familjare”.

Pikërisht, raporti nga kjo prokurori jep një argument të fuqishëm përse konsiderojmë se ka përzierje të nocioneve ligj zbatues vs ligjvënës, ngase me lehtësi gjykatat kanë marrë aktgjykime me konfiskim të veturave të viteve 1985 -1991, mirëpo ka pasur hezitim të konfiskimit të mjeteve me të cilat janë kryer veprat penale.

Poashtu, shqetësuese është fakti se gjykatat asnjëherë nuk kanë zbatuar nenin 92, apo hapat 2 dhe 3 në këtë nen.

4. Pth Gjilani ka raportuar se kanë zbatuar nenin 92 në 5 raste.

Në së paku 9 raste, sipas raportimit gjykatat nuk kanë marrë fare vendime, qoftë për aprovim të kërkesave për shitje, qoftë për refuzim të tyre dhe rastet i përkasin viteve 2022 dhe 2023.

Edhe në këtë prokurori kemi situatë të ngjashme me atë të Ferizajt, respektivisht shumë asete janë kthyer tek të pandehurit.

5. Pth Mitrovica ka raportuar se kanë zbatuar në disa raste nenin 92 të KPRK-së, por pa ndonjë të dhënë konkrete, edhe pse nga raportet që kemi pranuar, e dimë se së paku në një rast është zbatuar neni në fjalë, që ka rezultuar madje me aktgjykim dënues dhe konfiskim të shumës prej 132,000.00 €.

Disa konstatime interesante nga kjo prokurori ishin si në vijim:

“Nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë janë paraqitur gjithsej katërdhjetë e tri (43) kërkesa për shitje të automjeteve, ku të aprovuara janë njëzetë e një (21), ndërsa janë në pritje edhe njëzet e dy (22) të tjera që nuk është vendosur ende nga gjykata.

Nga kërkesat e paraqitura në gjykatë lidhur me shitjen e aseteve ju informoj se gjykata deri më tani nuk ka refuzuar asnjë kërkesë, për rastet për të cilat nga gjykata paraprakisht ishte lëshuar Urdhri ndalues përfundimtar”.

6. Pth Peja ka raportuar se kanë zbatuar në 0 raste nenin 92 të KPRK-së.

Disa konstatime interesante nga kjo prokurori ishin si në vijim:

“Po ashtu kemi kërkuar edhe AMPSK listën e mjeteve që janë nga Prokuroria Themelore në Pejë dhe kemi parashtruar **11 kërkesa për shitje** të veturave ose ndryshim të masave, prej të cilave 1 është refuzuar dhe është parashtruar ankesa, 1 rast tjetër nuk është aprovuar kërkesa

për shitje por është zëvendësuar me masën mbajtja në depo të sigurt, **3 tjera janë aprovuar** gjersa për të tjera jemi në pritje”.

7. Pth Prizreni ka raportuar se kanë zbatuar nenin 92 në 4 raste:

- a. PP/II.nr.1141-14/21, vepra penale mashtrimi, prokurori Petrit Kryeziu;
- b. PP/II.nr.179-14/22, vepra penale fajdeja - detyrimi, prokurori Petrit Kryeziu;
- c. PP/II.nr.1841-3/23, vepra penale shantazhi, prokurori Labinot Jetishi;
- d. PP/I.nr.124/23, vepra penale fajdeja, prokurori Petrit Kryeziu.

Disa konstatime interesante nga kjo prokurori ishin si në vijim:

- “lidhur me kërkesën për sigurim të informatave lidhur me kërkesat për shitje të veturave, në attach të bashkëngjitur në detaje i gjeni të dhënat e kërkuara.
Për më tepër, ju informoj se kemi parashtruar 59 kërkesa për shitje të pasurisë së specifikuar - automjete, të aprovuara 36, të refuzuara 12;
Kërkesë për ruajtje 9;
Kërkesë për konfiskim 8;
Kërkesë për dhënie në shfrytëzim policisë 5, nga to 5 të aprovuara;
Kërkesë për kthim të automjetit 3;
Kërkesë për shkatërrim të automjetit 1.

8. PSRK ka raportuar se ka zbatuar nenin 92 në 4 raste:

- a.) PPS.nr.38/21 prokurori Milot Krasniqi
- b.) PPS.nr.88/22 prokurori Valdet Gashi
- c.) PPS.nr.69/22 prokurori Dren Paca
- d.) PPS.nr.27/23 prokurori Dren Paca.

Në total, shihet se të gjitha prokuroritë kanë zbatuar nenin 92 në 18 raste, për 6 vite që kur ka hyrë në fuqi KPRK dhe 2 vite që kur ka hyrë në fuqi KPP.

Nga analiza e raporteve që kemi pranuar dhe analiza në përgjithësi e rasteve që kemi trajtuar, mund të thuhet sikur ekziston një lloj “mëshire” e prokurorëve dhe gjyqtarëve, në hezitimin për të zbatuar nenin 92 të KPRK-së, dispozitave të konfiskimit në tërësi, LKZK-së dhe shitjes së aseteve. Mirëpo, kjo “mëshire” përveç që nuk ka mbështetje ligjore, është edhe jo korrekte

dhe e pa sinqertë. Psh nga raporti i Pth-së në Gjakovë vihet re se ka gatishmëri të lartë të konfiskimit të veturave të vjetra të viteve 1985 – 1991. Mirëpo, nuk shihet gatishmëri e tillë tek konfiskimi i mjeteve me të cilat janë kryer veprat penale, sikur se të veprat penale kundër ambientit, psh ekskavatorëve, lugëve dhe pajisjeve tjera me të cilat eksploatohen me ton rërë e zhavorr.

Andaj, mendojmë se “mëshira” është jo korrekte dhe e pasinqertë sepse nëse do të pranohej për një moment baza e mbështetjes tek “mëshira”, atëherë si është e mundur që ka gatishmëri të lartë për konfiskim të veturave të viteve 1985 -1991 (që kanë vlerë prej 100 -500 €) por nuk ka gatishmëri të tillë të konfiskohen mjetet me të cilat kryhen veprat penale kundër ambientit? Në rastet e veprave penale kundër ambientit, eksploatohen me tonelata rërë e zhavorr, investohen me qindra mijëra euro në biznese të tilla dhe dëmet në florën e faunën e vendit janë të mëdha. Dëme shkaktohen edhe në ruajtjen e biodiversitetit, balancën e ekosistemeve, prodhimin e oksigjenit.

Mjafton të thuhet se në të kaluarën, 11 fëmijë kanë gjetur vdekjen në gropat e eksploatuara dhe të pambuluara nga kryesit e veprave penale kundër ambientit.

Këto vepra penale kanë potencial shkaktojnë edhe tragjedi të përmasave të mëdha. Mjafton të përkujtohet tragjedia e ndodhur në B e H në vitin 2024, e që kishte të bëj me punimet në një gurore atje. Atje u shkaktuan 16 viktima dhe miliona dëme financiare.

Dhe pikërisht këto fakte, sugjerojnë atë që e kemi thënë në fillim të këtij kapitulli, se prokurorët dhe gjykatësit po tejkalojnë rolin e tyre të ligj zbatuesve, duke marrë kompetenca që ligji nuk u ka dhënë.

Ose edhe ajo që si duket një pjesë e prokurorëve dhe gjykatësve, “mendojnë” se pasoja e dëmshme shkaktohet vetëm me armë apo thikë, e që natyrisht se nuk qëndron sepse shembulli i rastit në B e H, por edhe disa vërshime që kanë ndodhur në Pejë në 2024, japin të kuptohet se pasojat janë të rënda dhe vdekjeprurëse edhe në rastet kur pasojat vijnë një moment më vonë, apo edhe disa vite më vonë.

Për të kuptuar më mirë këtë qasje të sistemit të drejtësisë, do të përpiqemi të sqarojmë përse një gjë e tillë nuk qëndron, edhe pse realisht një gjë e tillë nuk do të duhet të diskutohej e as sqarohej tek një nivel i tillë i profesionistëve, sikurse janë prokurorët dhe gjykatësit.

Pra, pse konfiskimi është i bazuar në ligj, pse është masë e drejtë dhe pse duhet të merret në konsideratë edhe interesit e të dëmtuarit?

Një parim themelor ka të bëj me atë se “krimi nuk shpaguhet”. Mesazhi kryesor që duhet të përçohet nga zbatuesit e ligjit është se herët apo vonë, dobia pasurore e fituar me vepër penale do të merret dhe kthehet aty ku është marrë. Pra, se zbatimi konsekuent e sistematik i ligjit do të thotë se krimi nuk shpaguhet me faktin se përmes zbatimit konsekuent të dispozitave ligjore, në një fazë, kurdo që të jetë ajo, pasuria e fituar me vepër penale do të konfiskohet. Qoftë ajo e paligjshme, qoftë e ligjshme deri në vlerën e dobisë së përfituar me vepër penale.

Konfiskimi kështoj nuk është i padrejtë sepse në esencë bazohet në prova dhe realizohet vetëm pasi që personi shpallet fajtor nga një gjykatë, në një proces gjyqësor dhe vetëm kur me prova dëshmohet vepra penale dhe dobia e fituar me vepër penale. Konfiskimi nuk është i padrejtë sepse zbaton parimin e drejtësisë duke rikthyer një ekuilibër që është shkelur nga veprimi i njëanshëm i të pandehurit. Andaj, zbatuesit e ligjit, posaçërisht prokurorët e gjykatësit duhet të kuptojnë se i dëmtuari me asnjë veprim nuk ka kontribuar në prishjen e atij ekuilibri.

Në raste të tilla, synimi i ligjit përmes konfiskimit, respektivisht nenit 92 të KPRK-së, është të sigurojë që personat që kanë përfituar dobi pasurore përmes veprës penale të mos lejohen të mbajnë pasurinë e tillë të kundërligjshme dhe përmes zbatimit konsekuent dhe sistematik të ligjit, ta kompensojnë qoftë të dëmtuarin, qoftë shoqërinë/shtetin.

Konfiskimi nuk është padrejtësi sepse mos kompensimi i viktimës mund të konsiderohet më i padrejtë sesa konfiskimi i pasurisë së ligjshme të kryesit të veprës penale, pasi që kompensimi i të dëmtuarit nuk është si masë e padrejtë që vepron mbi pasurinë e të pandehurit. Andaj, zbatuesit e ligjit, prokurorët e gjykatësit, nuk do të duhej të lejojnë situatën kur të pandehurit pretendojnë se “kanë shpenzuar pasurinë e ligjshme” dhe të thirren tash në kinse në emër të mbrojtjes së të drejtave të tyre. Të drejtat e tyre realisht nuk shkelen ngase vetëm po rikthehet ekuilibri i prishur nga veprimi kriminal i të pandehurve dhe është e papranueshme që të pandehurit të llogarisin se ata mund të shpenzojnë pasuritë e paligjshme dhe të shmangin kompensimin e dëmit.

Konfiskimi përmes nenit 92 të KPRK-së poashtu nuk është i padrejtë sepse bazohet në ligj. Neni 38.1.3 i KPRK-së, përcakton se qëllimi i dënimit është mes tjerash të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale.

Konfiskimi përmes nenit 92 të KPRK-së poashtu nuk është i padrejtë sepse bazohet në ligj. Neni 48.1.1 i KPP-së poashtu përcakton se prokurorët e shtetit janë të autorizuar për të

përfaqësuar interesat publike para gjykatave dhe të kërkojnë nga gjykata që të urdhërojë masa në pajtim me këtë kod. Andaj, konfiskimi përmes nenit 92 të KPRK-së, pos që ka mbështetje në ligj, ka edhe ndikimin shoqëror, parandalues për të pandehurin dhe të tjerët dhe ka funksion edhe edukativ.

Konfiskimi përmes nenit 92 të KPRK-së, nuk është i padrejtë sepse trajton palët në procedurën penale me barazi, paanshmëri dhe dinjitet. I pandehuri gjithmonë do të përpiqet të shmangë konfiskimin me pretendimin se po “ndërhyhet në pasurinë e ligjshme të tij” (hapat 2, 3 dhe 4 të nenit 92), mirëpo në të vërtetë nëse zbatuesit e ligjit, prokurorët dhe gjykatësit hezitojnë të zbatojnë nenin 92, sikurse po shihet se realisht po ndodhë në praktikë, atëherë po krijohet një pabarazi mes të pandehurit dhe të dëmtuarit. I dëmtuari nuk ka kontribuar fare në krijimin e një jo ekuilibri faktik. Ai i është bindur ligjeve, punon dhe ka krijuar një pasuri me punë të ndershme, ekuilibër që është prishur nga veprimi i njëanshëm i të pandehurit, andaj konfiskimi, qoftë i vlerës zëvendësuese në hapin 2 të nenit 92, qoftë pasurisë së ligjshme të tij në hapin 3 të nenit 92, apo edhe fare në fund qoftë të nenit 275 të KPP-së apo të pasurive shtesë që paraqet hapin e 4-të dhe final të konfiskimit të rregullt, është i bazuar në ligj, praktika ndërkombëtare dhe i drejtë në koncept. Duke rivënë një ekuilibër të prishur nga veprimi i të pandehurit.

Konfiskimi i pasurisë së të pandehurit përmes nenit 92 të KPRK-së nuk është i padrejtë sepse qoftë konfiskimi i vlerës zëvendësues, qoftë pasurisë së ligjshme, qoftë të pasurive shtesë të krijuara në të ardhmen është gjithmonë proporcional me përfitimin e padrejtë që është marrë nga vepra penale e kryer nga i pandehuri. Pra, sistemi i drejtësisë, asnjëherë nuk konfiskon më shumë se vlera e dobisë pasurore të krijuar me vepër penale. Kjo siguron që masat të jenë të drejta dhe të bazuara në parime ligjore.

Një mënyrë e tillë e të vepruarit gjen mbështetje edhe në praktikat ndërkombëtare.

1. Direktiva e BE-së për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Krimit të Organizuar

Legjislacionet e vendeve të BE-së bazohen në direktivat e BE-së, si **Direktiva 2014/42/BE**, ku bazohet edhe vendi ynë, që kërkon nga shtetet anëtare të lejojnë konfiskimin jo vetëm të pasurisë së fituar nga krimi, por edhe të vlerave ekuivalente. Në rastet kur pasuria kriminale nuk është e disponueshme (p.sh., është shitur, tjetërsuar ose fshehur), shtetet kanë mekanizma për konfiskimin e pasurisë ligjore të të pandehurit në një masë ekuivalente.

Ka një mori ligjesh tjera, si Ligji Britanik - *Proceeds of Crime Act 2002 (POCA)*, që lejon konfiskimin e pasurisë me vlerë ekuivalente në rastet kur pasuria kriminale nuk është e disponueshme. Kjo mund të ndodhë kur pasuria është transferuar, tjetërsuar ose konsumuar. Pastaj është Ligji në SHBA - RICO Act dhe Civil Asset Forfeiture, legjislacioni në Itali që paraqet një koncept të tillë dhe madje edhe më agresiv në krahasim me shumë vende tjera, meqenëse Italia ka një nga sistemet më të zhvilluara të konfiskimit të pasurisë kriminale, veçanërisht në luftën kundër mafias. Në bazë të Ligjit nr. 575/1965 dhe ndryshimeve të mëvonshme, konfiskohet pasuria ligjore e të pandehurit nëse pasuria kriminale nuk është e disponueshme. Edhe Ligji në Gjermani - *Strafgesetzbuch (StGB)* dhe *StPO*, edhe në Shqipëri, ligji antimafia (Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009) lejon konfiskimin e pasurisë së ligjshme, përfshirë vlerat zëvendësuese, kur provat tregojnë se pasuria kriminale është fshehur, konsumuar ose tjetërsuar si dhe Konventa e Palermos (2000) dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin e Parave (2005) inkurajojnë shtetet të miratojnë masa për konfiskimin e pasurisë kriminale, përfshirë vlerat zëvendësuese.

Të gjitha këto si më sipër, shpijnë në një përfundim se konfiskimi sipas nenit 92, është detyrë ligjore e prokurorëve dhe jo zgjedhje e tyre. Mos veprimi sipas këtij neni do të thotë mos veprim sipas ligjit, tejkalim i kompetencave ligjore dhe uzurpim i kompetencave të ligjvënësve (duke menduar se masa e konfiskimit është e padrejtë), është i padrejtë ndaj të dëmtuarve dhe shkel parimet themelore për një drejtësi, edhe për të dëmtuarin dhe për një proces gjithëpërfshirës të drejtë e të rregullt.

Nga të gjitha këto, hezitimi i prokurorëve dhe gjykatësve për të zbatuar ligjin në tërësinë e tij, në konceptin dhe frymën e tij, përpos që është mos zbatim i ligjit, paraqet zbatim selektiv të ligjit me faktin se prokurorët dhe gjykatësit duket se zbatojnë ato dispozita ligjore që ata “i konsiderojnë të drejta dhe të bazuara”, është edhe tejkalim i kompetencave apo marrje e kompetencave që ligji nuk na njeht si të tilla dhe injorim i interesit publik dhe interesit të të dëmtuarit për një proces ku adresohet dëmi pasuror që ka pësuar, qoftë i dëmtuari, qoftë shteti.

Për këtë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë mekanizmat ligjor kushtetues, sikurse janë vlerësimi i performancës, përzgjedhja sipas meritokracisë, procedurat disiplinore etj. dhe për këtë ekzistojnë KPK, KGJK, Kryeprokurori i Shtetit, që në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre të sigurojnë se ligji po zbatohet në tërësinë e tij, dhe jo zbatim selektiv të neneve sipas “konsideratave morale të prokurorëve e gjykatësve” dhe kur ka dështim në

performimin sipas standardeve ligjore, atëherë duhet të diskutohet se cila është rruga për të arritur deri tek një objektiv i tillë. Nuk po aludojmë domosdoshmërisht në procedura disiplinore, mirëpo poashtu, është e papranueshme që me kaq shumë raste penale, kur dihet se shumica e veprave penale kryhen me motivin e dobisë pasurore, neni 92 i KPRK-së, shitja e aseteve, dispozitat e konfiskimit në përgjithësi dhe zbatimi i LKZK-së të jetë kaq i varfër, madje në nivelin zero në disa prokurori e gjykata.

6. LIGJI MBI KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT

LKZK e re ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019. Çdo aktgjykim që merret pas datës së hyrjes në fuqi, ka mundësi që LKZK e re të aplikohet dhe kjo paraqet një mundësi të mirë për sistemin gjyqësor të vendit që shifrat e konfiskimeve t'i rrisë duke shfrytëzuar këtë ligj që është shumë më i fuqishëm se sa ai i kaluari.

Kështu, PTH Peja, ka 5 raste në proces e sipër sipas këtij ligji.

Pth Prizreni ka 1 rast.

PSRK ka 2 raste sipas këtij ligji.

Pth Prishtina ka 1 rast.

RAPORT TREMUJOR

Tetor – dhjetor 2024

7. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Legjislacioni:

- Takime në kuadër të grupit punues për projektligjin PPP/LFT;
- Pjesëmarrja në takimet e grupit punues ACT NRA në muajin nëntor dhe dhjetor 2024, shqyrtimi dhe diskutimi i pikave të caktuara dhe vazhdimi i përpilimit të raportit të vlerësimit VKRr-NRA.
- Pjesëmarrja në kuadër të grupit punues për Projekt UA për Zbatimin e Ligjit Nr 08L146 për Sanksionet Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara për Personat Raportues.

Operacionet:

Banka Qendrore e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer dy (2) ekzaminime në fushën PPP/LFT në institucionet financiare si në vijim:

1. Ekzaminimi në institucionin financiar UFP SH.A,
2. Ekzaminimi në institucionin financiar Raiffeisen Bank SH.A

Bashkëpunimi dhe trajnimet:

- Punëtorja (Ëorkshop) “*Threats, Vulnerabilities and Emerging Financial Crime Risks linked to Innovative and Emerging Technology in Financial Services*”, nëntor 2024 KiE në Strasbourg, France;
- Konferenca e kolegjit për PPP/LFT e CESEE “*2nd (High Level) AML/CFT College Conference for CESEE*”, nëntor 2024 Banka Qendrore e Hungarisë-MNB në Budapest”.

8. NJËSIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

Sipas mandatit të vet ligjor misioni i Njesisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NjIF-K) është të udhëheqë përpjekjet e Qeverisë për përmirësimin e parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar. Funksionimi i duhur i sistemit si tërësi, përmes bashkëpunimit të ngushtë institucional dhe aktiviteteve të Njesisë për Inteligjencë Financiare është objektiva kryesore e NjIF-K.

Në tetor 2024, është bërë lansimi i Rrjeti i Përbashkët i Inteligjencës Kundër Pastrimit të Parave në Kosovë (JMLINK). Themelimi i JMLINK përbën një hap të rëndësishëm përpara në përpjekjet e Kosovës për të forcuar stabilitetin financiar dhe për të luftuar veprimtaritë e paligjshme financiare. Rrjeti do të mundësojë një bashkëpunim të vazhdueshëm midis autoriteteve të sundimit të ligjit, sektorit financiar, sektorit publik, bankave dhe institucioneve financiare dhe palëve të tjera të interesit, duke përmirësuar aftësinë tonë kolektive për të zbuluar dhe parandaluar pastrimin e parave që përbëjnë rrezik si për sistemin financiar vendor, ashtu edhe për ato ndërkombëtare. JMLINK do të shërbejë si mekanizëm i bashkëpunimit ndërinstucional dhe partneritetit publik-privat për të mbështetur dhe koordinuar përgjigjen e Kosovës në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të ndërlidhura penale. Përmes themelimit të këtij mekanizmi synohet të krijohet një qendër kombëtare me shumë agjenci për të mbështetur dhe koordinuar përgjigjen e sektorit publik dhe

atij privat në Kosovë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke optimizuar kapacitetet kolektive për të identifikuar, parandaluar, dhe luftuar krimin ekonomik. Në dhjetor 2024, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Projektligjin për plotësim-ndryshimin e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit.

Gjithashtu në periudhën raportuese është aprovuar edhe Ligji Nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues.

Dy takime të ekipit të grupit teknik analitik të përbërë nga zyrtar të NJIF-K, Prokuroria e Shtetit, Policia e Kosovës, ATK dhe BQK janë zhvilluar në këtë periudhë.

Një sërë trajnimesh, punëtorish janë mbajtur nga zyrtarët e NJIF-K, ku ndër më kryesoret janë paraqitur si në vijim:

- Tryeza e rumbullakët tre ditore për Procedurën e Konfiskimit 15 - 18 tetor 2024 - Durrës Shqipëri;
- Training on AI Applied to Law Enforcement Agencies;
- 9th Regional Security Coordination Conference;
- Eastern Balkans Digital Asset Investigations Working Group.

Gjatë këtij tremujori të vitit 2024, NJIF-K ka pranuar gjithsej 289 raporte të transaksioneve/aktivitetit të dyshimtë. Në kuadër të bashkëpunimit me agjencionet e zbatimit të ligjit dhe autoritet tjera vendore, mbi bazën e kërkesave për informata, janë shkëmbyer 62 raporte të inteligjencës financiare.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me homologët e huaj, NJIF-K ka shkëmbyer gjithsej 26 raporte/kërkesa të inteligjencës financiare.

9. POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës ka raportuar se gjatë këtij tremujori të katërt ka pasur këto aktivitete të trajnimit:

DIVIZIONI I TRAJNIMEVE

Divizioni i Trajnimeve ka për objektiv ngritjen e kapaciteteve profesionale për gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës, përmes trajnimeve themelore, të avancuara dhe të specializuara, duke u organizuar brenda dhe jashtë vendit.

Divizioni i Trajnimeve ka realizuar disa aktivitete me organizatat tjera me qellim të ngritjes së bashkëpunimit në përkrahje të mbajtjes së trajnimeve të specializuara brenda apo jashtë vendit, në veçanti kur një trajnim i tillë nuk është i mundshëm të realizohet nga kapacitetet e Policisë.

Paraqitja tabelore e trajnimeve të realizuara për periudhën **01.10.2024 deri me 31.12.2024**

1	Trajnim Njësia për Inteligjencë Financiare-Kosovë	Ambasada Britaneze	1	2
2	Trajnim për pastrimin e parave	Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar	2	8
3	Trajnim Mashtrimet ne Prokurimin Publik	ICITAP	1	7
